

VENDIM
Nr. 759, datë 19.12.2025

**PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) apartamenteve në 3 (tri) ndërtesa me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës të inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE TË PËRFUNDUARA NË ZONËN “KOMBINAT” , TË KOLAUDUARA □

Nr.	Emërtimi i Kontratës	Vlera e Objektit sipas Kontratës (Ndërtim+Montim+Projektim)	Vlera e Situacionit Përfundimtar (Ndërtim+Montim)	Vlera e Studim Projektimit	Vlera e Mbikqyrjes se Punimeve	Vlera e Kolauditimit te Punimeve	Vlera Totale	Sipërfaqe Banimi Bruto Ap. (m2)	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Total Apartamente (Nr)
1	Banesë kolektive Godina 7 (Seksioni B)	541,400,000.00	530,978,971.00	10,421,029	3,850,000	150,000	545,400,000	8,660.74	50	30	5	85
2	Banesë kolektive Godina 4 (Seksioni B)	544,000,000	535,509,839	8,490,161	3,819,000	117,000	547,936,000	8,536.48	30	40	5	75
3	Banesë kolektive Godina 7 (Seksioni D)	199,800,000	194,103,369	4,195,942	1,440,000	50,000	199,789,311	3,432.85	7	14	7	28